

**ARTICLES OF ASSOCIATION
AND STATUTE OF
THE
LIMITED LIABILITY COMPANY**

**GLOBAL VAT COMPLIANCE ALBANIA
SHPK**

**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI
I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR**

**GLOBAL VAT COMPLIANCE
ALBANIA SHPK**

Article 1
Incorporation, Name

(1) Today on August 1st, 2023, at the address: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tirana, Albania, the following founding shareholders:

- **Global VAT Compliance B.V.**, a private limited company, having its legal headquarter in Loire 192, 2491AM 's-Gravenhage, the Netherlands, registered with commercial registration no. 27377928, with VAT number: NL 822312852B01, duly represented by Mr. Hendrik Hop, in his quality as the legal representative, (hereinafter "GVC");
- **Western Balkan Alliance Sh.p.k.**, a limited liability company, having its legal headquarter in Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tirana, Albania, with NUIS no. M02304017Q, duly represented by Mrs. Silvana Kuqo, in her quality as the legal representative, (hereinafter the "WBA");
- **Mr. Gerond Begolli**, an Albanian citizen, born in Korçë, Albania, on 13.06.1986 resident in Tirana, identified with ID no. I60613026V, currently valid, (hereinafter the "GB").

who declare that they accept with their free will the clauses and provisions set forth below, the drafting of the Articles of Association and Statute of the company named **Global VAT Compliance Albania Sh.p.k.** (abbreviated name "GVC Albania") (hereinafter the "Company") in accordance with the provisions of Law no. 9901 dated 14.04.2008, "On Entrepreneur and Commercial Companies" (the "Company Law").

Article 2
Scope of Business

The scope of the Company is to carry out any business activity permitted by the applicable law, including but not limited to the provision of indirect tax compliance services and the carrying out of all other activities which are deemed incidental or conducive to the attainment of the above scope. Additionally, the Company may enter into any transaction

Neni 1
Themelimi, Emri

(1) Sot më 1 Gusht 2023, në adresën: Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri, ortakët themelues në vijim:

- **Global VAT Compliance B.V.**, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Loire 192, 2491AM 's-Gravenhage, Vendet e Ulëta, regjistruar me nr. regjistri tregtar 27377928, me nr. TVSH NL 822312852B01, përfaqësuar rregullisht nga Z. Hendrik Hop, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor, (në vijim "GVC");
- **Western Balkan Alliance Sh.p.k.**, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Rruga Margarita Tutulani, Pallati Viridario 1, Kati 2, Tiranë, Shqipëri, me NUIS nr. M02304017Q, përfaqësuar rregullisht nga Znj. Silvana Kuqo, në cilësinë e përfaqësueses ligjore, (në vijim "WBA");
- **Z. Gerond Begolli**, shtetas shqiptar, lindur në Korçë, Shqipëri, më 13.06.1986 banues në Tiranë, identifikuar me ID I60613026V, e vlefshme, (në vijim "GB").

të cilët deklarojnë se i pranojnë me vullnetin e tyre të lirë dispozitat e parashikuara më poshtë, hartimin e Aktit të Themelimit dhe Statutit të Shoqërisë **Global VAT Compliance Albania Sh.p.k.** (në vijim i shkurtuar "GVC Albania") në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare të Republikës së Shqipërisë ("Ligji Tregtar").

Neni 2
Objekti i Aktivitetit

Objekti i Shoqërisë është të ndërmarrë çdo lloj aktiviteti tregtar të lejuar nga ligji i zbatueshëm, duke por përfshirë por pa u kufizuar në, ofrimin e shërbimeve të përputhshmërisë së detyrimeve tatimore indirekte si dhe kryerjen e të gjitha aktiviteteve të tjera që konsiderohen të ndërlidhura apo ndihmëse për arritjen e

Gerond Begolli

Begolli

that it deems suitable or necessary for the ultimate purposes of achieving the aforementioned scope.

objektit të mësipërm. Për më tepër, Shoqëria mund të hyjë në çdo transaksion i cili konsiderohet i dobishëm apo i nevojshëm për përmbushjen e objektit të mësipërm.

Article 3 Duration

The Company is incorporated for an indefinite period of time, from the date of registration at the commercial registry.

Neni 3 Kohëzgjatja

Shoqëria themelohet për një periudhë kohe të papërcaktuar, duke nisur nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar.

Article 4 Fiscal Year, Financial Statements

(1) The fiscal years are defined as the calendar years.

(2) The financial statements have to be drawn up and signed by all managing directors for submission and approval by the general meeting, within the stipulated statutory period.

(3) In special circumstances the General Meeting, except for the statutory financial statements, may prepare and approve interim financial statements for a period of less than a calendar year.

Neni 4 Viti Financiare, Pasqyrat Financiare

(1) Vitet financiare janë të përcaktuara si vitet kalendarike.

(2) Pasqyrat financiare duhet të hartohen dhe nënshkruhen nga të gjithë administratorët, për paraqitje dhe miratimin nga asambleja brenda afatit ligjor.

(3) Në raste të veçanta Asambleja mund të vendosë të miratojë, përveç pasqyrave financiare vjetore, edhe pasqyra financiare periodike për një periudhë të ndërmjetme.

Article 5 Registered Office

(1) The registered office of the Company is in the address noted in Annex 1 attached hereto as an integral part of this Statute.

Neni 5 Selia

(1) Selia e Shoqërisë është në adresën e shënuar në Aneksin 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

Article 6 Registered Capital, Shareholders

(1) The registered capital of the Company is determined in the Annex 1, attached hereto as integral part of this Statute.

(2) The Company's capital is equal to ALL 660,000 (six hundred sixty thousand Lekë). The capital consists of 3 (three) shares, representing 100% of the registered share capital, as follows:



- 1 (one) share equal to 51% of the share capital, equal to Lekë 336,600 (three hundred thirty-six thousand and six hundred), held by the shareholder GVC;

Neni 6 Kapitali i Regjistruar, Ortakët

(1) Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është shënuar në Aneksin 1 bashkëlidhur, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

(2) Kapitali i Shoqërisë është 660,000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë. Kapitali përbëhet nga 3 (tre) kuota, që përfaqësojnë 100% të kapitalit themeltar të regjistruar, si vijon:

- 1 (një) kuotë e barabartë me 51% të kapitalit, e barabartë me 336,600 (treqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind) Lekë, zotëruar nga ortaku GVC;



- 1 (one) share equal to 34% of the share capital, equal to Lekë 224,400 (two hundred four thousand and four hundred), held by the shareholder WBA;
- 1 (one) share equal to 15% of the share capital, equal to Lekë 99,000 (ninety-nine thousand), held by the shareholder Gerond Begolli.

(3) The capital of the Company owned by the founding shareholders is further identified in Annex 1, attached hereto as an integral part of this Statute.

(4) The Company's capital is fully subscribed by the shareholders.

- 1 (një) kuotë e barabartë me 34% të kapitalit, e barabartë me 224,400 (dyqind e njëzetë e katër mijë e katërqind) Lekë, zotëruar nga ortaku WBA;

- 1 (një) kuotë e barabartë me 15% të kapitalit, e barabartë me 99,000 (nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë, zotëruar nga ortaku Gerond Begolli.

(3) Kapitali i Shoqërisë në pronësi të ortakëve themelues është identifikuar më tej në Aneksin 1, pjesë përbërëse e këtij Statuti.

(4) Kapitali i Shoqërisë është nënshkruar tërësisht nga Ortakët.

Article 7 Amendments to the Share Capital and New Contributions

(1) The General Meeting may resolve to increase or decrease the share capital of the Company pursuant to the Company Law.

(2) The subscription and payment of further contributions in cash shall be completed not later than the term decided in the resolution passing the increase.

Article 8 Transfer of Shares

(1) The transfer of the Company shares shall be made in writing, and in compliance with the requirements of the Company Law and this Statute.

(2) The transfer *inter vivos* of shares to third parties shall be subject to the relevant provisions of this Statute and the applicable law.

(3) The general meeting may resolve to split a share for the purpose of its partial transfer, as well as determine conditions for the transfer of shares to third parties, including pre-emption rights in favour of existing shareholders.

(4) In case of death or bankruptcy/liquidation of a shareholder, the respective shares shall pass to the heir(s) pursuant to the applicable legal provisions.

Neni 7 Ndryshimet e Kapitalit Kontributet e Reja

(1) Asambleja e ortakëve mund të vendosë të zmadhojë ose zvogëlojë kapitalin e Shoqërisë sipas Ligjit Tregtar.

(2) Nënshkrimi dhe shlyerja e kontributeve të mëtejshme në para do të kryhet brenda afatit të përcaktuar në vendimin që miraton zmadhimin.

Neni 8 Transferimi i Kuotave

(1) Transferimi i kuotave do të bëhet me shkrim, dhe në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar dhe në këtë Statut.

(2) Transferimi *inter vivos* i kuotave të palët e treta i nënshtrohet dispozitave përkatëse të këtij Statuti dhe ligjit në fuqi.

(3) Asambleja mund të vendosë ndarjen e një kuote, me qëllim transferimin e pjesëshëm të saj, dhe kushte për transferimin e kuotave ndaj të tretëve, përfshi këtu të drejtën e parablerjes në favor të ortakëve ekzistues.

(4) Në rast të vdekjes ose falimentimit/likuidimit të një ortaku, kuotat përkatëse i kalojnë trashëgimtarit(ve) sipas dispozitave ligjore në fuqi.

[Handwritten signature]

HH

[Handwritten signature]

Article 9
Distribution of Profits

(1) The Company may distribute to shareholders only the profits that are available under its financial statements stated above in article 4 of this statute, if, after the payment:

a) the Company's assets will fully cover its liabilities, and

b) the Company will have sufficient liquid assets to make payments for its liabilities as they fall due in the next twelve months.

(2) The managing directors shall issue a 'solvency certificate', which explicitly confirms that the proposed distribution meets the valuation as of paragraph 1. Where the accounts of the Company indicate that the proposed distribution cannot meet the valuation of paragraph 1, the managing directors may not issue the solvency certificate.

(3) The shareholders acknowledge and agree that the profit shall be distributed according to the percentages as indicated under paragraph (4) of this article, depending on the type of project that has generated the profits. The Company categorizes its projects into two categories: (i) GVC projects, and (ii) non-GVC projects. The activities that fall under the GVC projects category are those projects that the service agreement is signed between the Company and GVC, and meet at least one of the following criteria:

- The Company is not involved in discussions and negotiations with the client.
- The Company has no access to the service agreement between GVC and the client.
- Company's fees account for less than 65% of the fees paid by the client to GVC.

For the purpose of dividend calculation, revenues and direct costs are allocated to these two project categories: (i) GVC projects and (ii) non-GVC projects. Indirect costs, such as general and administrative expenditures, are allocated to each project category based on their respective revenues divided by the total revenues.

Neni 9
Shpërndarja e Fitimit

(1) Shoqëria mund t'u shpërndajë ortakëve fitimet e disponueshme sipas pasqyrave financiare të përmendura në nenin 4 të këtij statuti, vetëm nëse pas pagimit:

a) aktivet e shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e saj;

b) shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

(2) Administratorët lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar e dividendëve përmbush kërkesat e pikës 1 të këtij neni, ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar e dividendëve nuk i përmbush këto kritere, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.

(3) Ortakët pranojnë dhe bien dakord që fitimi të ndahet sipas përqindjeve të përcaktuara në paragrafin (4) të këtij neni, në varësi të llojit të projektit nga i cili është gjeneruar fitimi. Shoqëria i kategorizon projektet e saj në dy kategori: (i) projekte GVC dhe (ii) projekte jo-GVC. Aktivitetet që bëjnë pjesë në kategorinë e projekteve GVC janë ato projekte që marrëveshja e shërbimit është nënshkruar ndërmjet Shoqërisë dhe GVC dhe plotëson të paktën një nga kriteret e mëposhtme:

- Shoqëria nuk është e përfshirë në diskutime dhe negociata me klientin.
- Shoqëria nuk ka qasje në marrëveshjen e shërbimit ndërmjet GVC dhe klientit.
- Tarifat e Shoqërisë përbëjnë më pak se 65% të tarifave të paguara nga klienti tek GVC.

Për qëllime të llogaritjes së dividendit, të ardhurat dhe kostot direkte u shpërndahen këtyre dy kategorive të projektit: (i) projektet GVC dhe (ii) projektet jo-GVC. Kostot indirekte, si shpenzimet e përgjithshme dhe administrative, caktohen për çdo kategori projekti bazuar në të ardhurat e tyre përkatëse të përpjesëtuara me të ardhurat totale.

(4) The shareholders hereby agree that the profit shall be distributed according to the below percentages regardless of each shareholder's participation in the Company's capital:

For (i) GVC projects the distribution of profits shall be:

GVC will benefit from: 0% (zero per cent);
WBA will benefit from: 70% (seventy per cent);
GB will benefit from: 30% (thirty per cent).

For (ii) non-GVC projects the distribution of profits shall be:

GVC will benefit from: 40% (forty per cent);
WBA will benefit from: 40% (forty per cent);
GB will benefit from: 20% (twenty per cent).

Article 10 Managing Directors, Appointment, Dismissal and Powers

(1) The Company is managed by 1 (one) managing director, appointed by the general meeting, for a term not exceeding 5 (five) years, with the possibility of renewal. The shareholder WBA has the exclusive authority to propose the individual holding the position of the managing director who will then be appointed by the general meeting. WBA shall provide the other two shareholders with the proposed name at least 5 (five) business days prior to the general meeting date. The candidate shall be an individual with a good reputation and a proven track record of leadership or finance, accounting, and tax background. The act of appointment of the managing director shall contain the term of office, scope of authority, and responsibility.

(2) Should the general meeting fail to appoint the proposal of the shareholder WBA under paragraph (1) above, the latter shall be granted the option to propose another name for the position of managing director. Should the general meeting fail to appoint also the second proposal of the shareholder WBA, the shareholders agree to dissolve the Company and initiate the liquidation procedures according to the relevant provisions of the Company Law. The appointment procedures under paragraphs (1) and (2) shall apply every

(4) Ortakët bien dakord që fitimi të shpërndahet sipas përqindjeve të mëposhtme, pavarësisht nga pjesëmarrja e secilit ortak në kapitalin e Shoqërisë:

Për (i) projektet GVC shpërndarja e fitimeve do të jetë:

GVC do të përfitojë: 0% (zero për qind);
WBA do të përfitojë: 70% (shtatëdhjetë për qind);
GB do të përfitojë: 30% (tridhjetë për qind).

Për (ii) projektet jo-GVC shpërndarja e fitimeve do të jetë:

GVC do të përfitojë: 40% (dyzet për qind);
WBA do të përfitojë: 40% (dyzet për qind);
GB do të përfitojë: 20% (njëzet për qind).

Neni 10 Administratorët, Emërimi, Shkarkimi dhe Kompetencat

(1) Shoqëria administrohet nga 1 (një) administrator i emëruar nga asambleja e ortakëve, për një afat jo më të gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Ortaku WBA ka autoritetin ekskluziv për të propozuar individin që mban pozicionin e administratorit i cili më pas do të emërohet nga asambleja e ortakëve. WBA do t'u japë dy ortakëve të tjerë emrin e propozuar të paktën 5 (pesë) ditë pune përpara datës së mbledhjes së asamblesë së ortakëve. Kandidati duhet të jetë një individ me reputacion të mirë dhe eksperiencë si drejtues ose financë, kontabilitet dhe tatime. Akti emërimit të administratorit do të përmbajë afatin e emërimit të tij, objektin e tagrave, dhe përgjegjësitë.

(2) Nëse asambleja e ortakëve nuk miraton propozimin e ortakut WBA sipas paragrafit (1) më sipër, këtij të fundit i jepet mundësia të propozojë një emër tjetër për pozitën e administratorit. Nëse asambleja e ortakëve nuk miraton as propozimin e dytë të ortakut WBA, ortakët bien dakord të shpërbëjnë Shoqërinë dhe të fillojnë procedurat e likuidimit sipas dispozitave përkatëse të Ligjit Tregtar. Procedurat e emërimit sipas paragrafëve (1) dhe (2) do të zbatohen sa herë që miratohet një administrator i ri





time a new managing director shall be appointed.

(3) The general meeting may dismiss the managing director at any time.

(4) The managing director shall have the rights, powers, and duties to perform actions provided in the Company Law, in this Statute and in relevant decisions of the general meeting.

(5) The general meeting may approve internal rules of procedure, which the managing directors are bound to follow, with respect to the management of the Company, including rules of procedure of the board of directors, prior consultation with and/or approval of determined actions by the general meeting. In addition, the managing director shall not exceed the budget thresholds set out by the decisions of the general meeting. The budget and thresholds shall be provided under the shareholders' agreement.

Article 11 Legal Representation

The managing director is the legal representative of the Company. The power of the managing director to solely represent the Company in relations with third parties, including any public authority and the judiciary, shall be set forth by the decision of the general meeting.

Article 12 Remuneration

The Company shall remunerate the managing director by decision of the general meeting pursuant to the agreed terms under the shareholders' agreement, and in compliance with the provisions of the Company Law.

Article 13 The General Meeting and Voting Rights

(1) The general meeting of shareholders is the highest governing body of the Company, and it exercises the rights and duties determined by the Company Law.

(2) The general meeting of shareholders is convened, holds valid meetings, and passes

(3) Asambleja e ortakëve mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë.

(4) Administratori ka të drejtat, kompetencat dhe detyrën të kryejnë veprimet e parashikuara në Ligjin Tregtar, në këtë Statut dhe në vendimet përkatëse të asamblesë së ortakëve.

(5) Asambleja e ortakëve mund të miratojë rregulla të brendshme procedurale, të detyrueshme për zbatim nga administratorët, në lidhje me realizimin e administrimit të Shoqërisë, përfshirë rregulla procedurale për këshillin e administrimit, konsultime me dhe/ose miratime paraprake për veprime të caktuara nga asambleja e ortakëve. Gjithashtu, administratori nuk duhet të kalojë kufijtë buxhetorë të përcaktuar me vendim të asamblesë së ortakëve. Buxheti dhe kufijtë do të caktohen me marrëveshje të ortakëve.

Neni 11 Përfaqësimi Ligjor

Administratori është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë. Kompetenca e administratorit për të përfaqësuar i vetëm Shoqërinë në marrëdhëniet me palët e treta, përfshirë çdo autoritet publik dhe gjyqësor, do të përcaktohet me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 12 Shpërblimi


Shoqëria shpërblen administratorin me vendim të asamblesë së ortakëve sipas kushteve të rena dakord në marrëveshjen e ortakëve, dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit Tregtar.

Neni 13 Asambleja e Ortakëve, të Drejtat e votës

(1) Asambleja e ortakëve është organi më i lartë vendimmarrës i Shoqërisë, dhe ushtron të drejtat e detyrimet e përcaktuara sipas Ligjit Tregtar.

(2) Asambleja e ortakëve thirret, mban mbledhje dhe miraton vendime të vlefshme

7 

 7

valid resolutions in accordance with the Company Law.

(3) Each share carries a number of votes equal to the portion of the share capital it represents. Each shareholder is granted the right to attend the meetings of the general meeting, to weigh in his own opinion as well as to exercise voting rights in proportion to share participation in the share capital.

(4) Each shareholder may be represented at the meetings either by another shareholder or third person, on the basis of a special power of attorney or authorization issued in writing. The shareholder cannot be represented by the managing director of the Company.

(5) The general meeting may be held at the Company's registered office or elsewhere, within the Republic of Albania or abroad. The shareholders may attend thereto either in person or by electronic means, by way of example by means of video or phone conference, provided that all of the participants are in the position to attend and timely follow all discussions. The general meeting shall be considered as regularly held with the presence of the chairman and the secretary of the meeting, for the purposes of chairing the meeting and drawing up the minutes in the relevant registry.

(6) The general meeting may be called either by the managing director or by the shareholders representing at least 5% of the share capital. The general meeting shall be convened by notice sent by registered mail with return receipt or electronic mail, [on condition that the said notices shall not be valid unless the same have been also sent to all shareholders at the addresses communicated to the Company by electronic mail], at least 7 (seven) days before the scheduled meeting. The notice of the meeting shall contain the items on the agenda, the place, the hour and the date of the meeting for the first and second calls.

(7) The general meeting shall be deemed duly convened, disregarding the mentioned convening formalities should all shareholders or their representatives attend thereto and agree on the items on the agenda.

në përputhje me parashikimet e Ligjit Tregtar.

(3) Secila kuotë ka një numër votash të barabartë me pjesën që ajo zë në kapitalin e Shoqërisë. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në mbledhjet e asamblesë së ortakëve, për të dhënë mendimin e tij si dhe për të ushtruar të drejtën e votës në proporcion me pjesëmarrjen në kapital.

(4) Çdo ortak mund të përfaqësohet në mbledhje nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë, me anë të një prokure të posaçme ose të një autorizimi të shkruar. Një ortak nuk mund të përfaqësohet nga administratori i Shoqërisë.

(5) Asambleja e ortakëve mund të thirret në selinë e Shoqërisë ose në një vend tjetër brenda Shqipërisë apo jashtë shtetit. Ortakët mund të marrë pjesë në këtë mbledhje vetë personalisht ose nëpërmjet mjeteve elektronike, si p.sh. video ose konferencë telefonike, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të jenë të pranishëm dhe të ndjekin në kohë të gjithë diskutimin. Asambleja e ortakëve, do të konsiderohet e mbledhur rregullisht kur janë të pranishëm kryetari dhe sekretari i mbledhjes, me qëllimin e drejtimit të mbledhjes dhe të hartimit të procesverbalit të mbledhjes në regjistrin përkatës.

(6) Asambleja e ortakëve mund të thirret nga administratori ose nga ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të Shoqërisë. Asambleja e ortakëve mund të thirret me anë të një njoftimi të dërguar më postë të regjistruar me lajmërim marrje apo me e-mail [me kushtin që këto njoftime nuk do të konsiderohen të vlefshme nëse nuk ju janë dërguar të gjithë ortakëve në adresat e dhëna Shoqërisë nëpërmjet postës elektronike], të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes së parashikuar. Thirrja për mbledhje duhet të përmbajë çështjet e rendit të ditës, vendin e mbledhjes, ditën dhe orën e mbledhjes për thirrjen e parë dhe të dytë.

(7) Asambleja e ortakëve do të konsiderohet e mbledhur rregullisht, pa patur parasysh formalitetet e thirrjes, nëse të gjithë ortakët apo përfaqësuesit e tyre, marrin pjesë në të dhe bien dakord për rendin e ditës.

Blazs HH

Bull

(8) The general meetings are chaired by one of the shareholders appointed at the beginning of the meeting. The general meeting appoints a secretary for each meeting among those present.

(9) The resolutions of the general meeting shall be in writing and signed by the chairman and the secretary. Upon shareholders' request, the resolutions shall also include any statements of the same.

(10) The general meeting is called at least once a year, within 6 (six) months from the closing of the financial year.

(11) The general meeting, in case of resolutions, requiring a simple majority of the votes, duly resolves only in case the voting shareholders represent more than 30% (thirty per cent) of the share capital attend thereto, either in person or by proxy, save for the cases indicated under paragraph (12) of this article. Should the said quorum not be reached, the general meeting is convened for a second call, within 30 (thirty) days from the first call.

(12) The general meeting, in case of resolutions, requiring a supermajority of the votes, duly resolves with the majority of 3/4 of the votes only in case the voting shareholders represent more than 75% (seventy-five per cent) of the share capital attend thereto, for the following matters: (i) amending the present Statute; (ii) increase or decrease of the share capital; (iii) distribution of profits; (iv) Company's reorganization and liquidation.

(13) According to the relevant provisions of Company Law, a shareholder may not exercise his voting rights if the general meeting is deciding on:

- a) the evaluation of his performance or its affiliated entities;
- b) his or its affiliated entities release from any obligations;
- c) the company lodging a lawsuit against him or its affiliated entities;
- d) granting him or its affiliated entities any benefit or entering into a service agreement.

(8) Asambleja e ortakëve kryesohet nga njëri prej ortakëve i cili caktohet në fillim të mbledhjes. Asambleja në çdo mbledhje emëron nga të pranishmit një sekretar të mbledhjes.

(9) Vendimet e asamblesë së ortakëve duhet të jenë në formë të shkruar dhe të firmosen nga kryetari dhe sekretari i mbledhjes. Me kërkesë të ortakëve, vendimi do të përmbajë çdo deklaratë të tyre.

(10) Asambleja e ortakëve mbledhet të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e mbylljes së vitit financiar.

(11) Asambleja e ortakëve, në rast se votimi kërkon një shumicë të thjeshtë votash, ai është i vlefshëm kur votojnë ortakët me të drejtë vote që përfaqësojnë më shumë se 30% (tridhjetë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, personalisht ose me përfaqësim, duke përjashtuar rastet e parashikuara në paragrafin (12) të këtij neni. Nëse nuk arrihet një kuorum i tillë, asambleja e ortakëve mbledhet me një thirrje të dytë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga thirrja e parë.

(12) Asambleja e ortakëve, në rastin e vendimeve të cilat kërkojnë një shumicë të kualifikuar të votave, merr vendime me shumicën e 3/4 të votave vetëm në rast se marrin pjesë ortakët që përfaqësojnë më shumë se 75% (shtatëdhjetë e pesë përqind) të kapitalit, për çështjet që vijnë: (i) ndryshimi i këtij Statuti; (ii) zmadhim ose zvogëlim të kapitalit themeltar; (iii) shpërndarjen e fitimeve; (iv) riorganizimin ose likuidimin e Shoqërisë.

(13) Bazuar në dispozitat përkatëse të Ligjit Tregtar, ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e ortakëve vendos për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij apo të subjekteve të lidhura;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij apo subjekteve të lidhura;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij apo subjekteve të lidhura nga shoqëria;
- d) dhënien atij apo subjekteve të lidhura të çdo përfitimi apo lidhjen e një marrëveshje shërbimi.

Blanca KH

